

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I PËR APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-066/12**

**Prishtinë, 3 tetor 2012**

Në çështjen juridike të:

**F. Gj., E. R.,**

**S. D1., H. M.,**

**M. V., S. D.2,**

**R. B., E. V.,**

**N.A., Z. I.,**

*Palët përgjegjëse në kërkesë/Palët ankuese*

**Përfaqësuar nga**

**Avokat**

**M. N.**

**kundër**

**D. S.**

*Paraqitësi i kërkesës/Pala përgjegjëse në ankesë*

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, Elka Filcheva-Ermenkova dhe Sylejman Nuredini, Anëtarë, duke vendosur me ankesat kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KKPK/D/R/137/2011 (lënda është e regjistruar në AKP me numrin KPA18191), të datës 07 dhjetor 2011 dhe ankesat kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/134/2011 (lënda është e regjistruar në AKP me numrat KPA18192, KPA18193, KPA18194, 18195 dhe 18196), të datës 07 dhjetor 2011, pas seancës së mbajtur me 3 tetor 2012, mori këtë

### AKTGJYKIM

- 1- Refuzohet si e pabazuar ankesa e F. Gj., E. R., S. D1., H.M., M. V., S. D2., R. B., E. V., N. A., Z. I., të përfaqësuar nga avokati M. N..
- 2- Konfirmohen vendimet e Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/137/2011 (lidhur me lëndën e regjistruar në AKP me numrin KPA18191), të datës 07 dhjetor 2011 dhe KPCC/D/A/134/2011 (lidhur me lëndën e regjistruar në AKP me numrat KPA18192, KPA18193, KPA18194, 18195 dhe 18196), të datës 07 dhjetor 2011.
- 3- Shpenzimet e procedurës në shumën prej € 530 (pesëqind e tridhjetë) duhet të paguhen nga palët ankuese ( €53 për secilin) Buxhetit të Kosovës brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 13 nëntor 2006, D. S. paraqiti gjashtë kërkesa pranë Agjencionit Kosova të Pronave (AKP), duke kërkuar të njihet si pronar i disa ngastrave të tokës dhe i një shtëpie të fituar me trashëgim dhe duke kërkuar ri-posedimin. Ai pohoi se i kishte trashëguar këto prona nga i ati i tij i ndjerë dhe se ato ishin humbur më 19 qershor 1999 si rezultat i konfliktit të armatosur në Kosovë në vitet 1998/99.
2. Të dhënat rreth ngastrave të kërkuara, të gjitha të regjistruara në Fletën Poseduese Nr. 5 në Drejtoratin Kadastral për Pronat e Paluajtshme në Prishtinë, të datës 19 prill 1968, janë si në vijim:

Numri i lëndës në AKP, relevante për pronën e kërkuar	Të dhënat rreth ngastrave
KPA18191	Ngastra Nr. 476, që ndodhet në komunën e Prishtinës, zona kadastrale Nëntë Jugoviq, Bora (Bare) Stamenković, me sipërfaqe prej 22a 11 metër katror.
KPA18192	Ngastra Nr. 191 që ndodhet në komunën e Prishtinës, zona kadastrale Nëntë Jugoviq, Bora (Bare) Stamenković, me sipërfaqe prej 38a 15 metër katror.  <i>*ekziston një mospërputhshmëri në tekstin e origjinalit të fletës poseduese në gjuhën Serbe dhe Shqipe përktbimit në gjuhën Angleze, vendimi merr parasysh të dhënat nga dokumenti origjinal;</i>
KPA18193	Ngastra Nr. 192 që ndodhet në komunën e Prishtinës, zona kadastrale Nëntë Jugoviq, Bora (Bare) Stamenković, me sipërfaqe prej 3a 70 metër katror. <i>*ibid;</i>
KPA18194	Ngastra Nr. 477 që ndodhet në komunën e Prishtinës, zona kadastrale Nëntë Jugoviq, Bora (Bare) Stamenković, me sipërfaqe prej 19a 10 metër katror. <i>*ibid;</i>
KPA18195	Ngastra Nr. 478 që ndodhet në komunën e Prishtinës, zona kadastrale Nëntë Jugoviq, Bora (Bare) Stamenković, me sipërfaqe prej 14a 68 metër katror. <i>*ibid;</i>
KPA18196	Ngastra Nr. 479 që ndodhet në komunën e Prishtinës, zona kadastrale Nëntë Jugoviq, Bora (Bare) Stamenković, me sipërfaqe prej 9a 35 metër

	katror. * <i>ibid</i> ;
--	----------------------------

3. Për t'i mbështetur pohimet e veta, paraqitësi i kërkesës paraqiti Fletën Poseduese Nr. 5 të lëshuar nga Drejtorati Kadastral për Pronë të Paluajtshme në Prishtinë, të datës 19 prill 1968; vendimin e gjykatës komunale të Prishtinës, të marrë në procedurën trashëgimore nr. 96/2000, të datës 9 nëntor 2000; sipas vendimit trashëgimor trashëgimia e B. S., i cili ka vdekur më 01 prill 1992 përfshinte tërë ngastrën që është objekt i kontestit të tanishëm. Vendimi po ashtu njih paraqitësin e kërkesës D. S. si trashëgimtar të vetëm.

4. Sekretariati Ekzekutiv i Komisionit ka verifikuar pozitivisht dokumentet e paraqitura nga paraqitësi i kërkesës dhe gjithashtu *ex officio* ka gjetur vërtetimin e pronës së paluajtshme në emër të paraqitësit të kërkesës, të datës 4/5 maj 2010 në Departamentin e Kadastrit në Prishtinë.

5. Pronat ku janë vënë njoftimet nga Sekretariati janë si në vijim: Ngastra 476 më 21 gusht 2007 (KPA18191); Ngastra 191 më 14 gusht 2007 (KPA18192); Ngastra 192 më 14 gusht 2007 (KPA19193); Ngastra 477 më 21 gusht 2007 (KPA19194); Ngastra 478 më 21 gusht 2007 (KPA19195) dhe Ngastra 479 më 14 gusht 2007.

Ekipi njoftues shkoi në vendin ku pretendohet se ndodheshin ngastrat dhe vendosi shenja që tregonin se prona është objekt i një kërkesë dhe se palët e interesuara është dashur t'i paraqesin përgjigjet e tyre brenda 30 ditëve. 10 persona të ndryshëm e prezantuan se kanë interes ligjor në procedurë pasi që pohonin se kishin të drejta ligjore ndaj pronave të ndryshme. Prandaj, ata kontestuan kërkesën.

6. Z.I., E. V., M. V., N. A., F. Gj., H. M., E. R., S. D.1, R. B. dhe S. D. pretenduan të drejta mbi ngastra të ndryshme apo mbi pjesë të ngastrave që janë objekt i kërkesës së D. S.. Të gjitha ata paraqitën kundërpadi se i kanë fituar të drejtat e tyre nëpërmjet kontratave me shkrim të lidhura me I.Sh. dhe njëri prej tyre me I. K., i cili gjithashtu e kishte marrë pronën nga i njëjti I. Sh.

7. Marrëveshjet, të cilat gjoja i legjitimojnë palët përgjegjëse në kërkesë si pronarë janë si në vijim: Z. I. – kontrata e blerjes, ref Nr. 3294/2002, e datës 21 qershor; E. V. – kontrata e blerjes, e datës 15 shtator 2001, e vërtetuar në Gjykatën Komunalë të Prishtinës me numrin Nr. 5394/2001 më 08 tetor 2001; M. V. me kontratën e blerjes, të datës 31 tetor 2002, e vërtetuar në Gjykatën Komunalë të Prishtinës me numrin Nr. 5994/2002 më 01 nëntor 2002; F.Gj.- kontrata e blerjes, e

datës 17 tetor 2001, e vërtetuar në Gjykatën Komunalë të Prishtinës me numrin Nr. 5589/2001 në të njëjtën ditë – 17 tetor 2001; H.M., - kontrata e blerjes, e datës 20 dhjetor 2001, e vërtetuar në Gjykatën Komunalë të Prishtinës me numrin Nr. 6853/2001 më 26 dhjetor 2001; E. R. – kontrata e blerjes, e datës 03 mars 2003, e vërtetuar në Gjykatën Komunalë të Prishtinës me numrin Nr. 1032/2003 më 03 mars 2003; S. D. – kontrata e blerjes, e datës 19 qershor 2002, e vërtetuar në Gjykatën Komunalë të Prishtinës me numrin Nr. 3293/2002 më 21 qershor 2002; R. B.– kontrata e blerjes (data në kontratë është e palexueshme), e vërtetuar në Gjykatën Komunalë të Prishtinës me numrin Nr. 4780/2002 më 27 gusht 2002; S. D.1 me kontratën e blerjes, të datës 16 maj 2002, e vërtetuar në Gjykatën Komunalë të Prishtinës me numrin Nr. 2543/2002 më 17 maj 2002.

Në të gjitha këto marrëveshje, shitësi gjithnjë ka qenë i njëjti person – I. Sh., i cili ka deklaruar se ka qenë zotërues i pronave.

N. A. nga ana tjetër ka blerë ngastrën e tij nga I. K., i cili nga ana e tij e kishte blerë nga I. Sh.. Tipar i veçantë në këtë rast është se kontrata ndërmjet I. K. si shitës dhe N. A. si blerës ka paraprirë në kohë kontratën ndërmjet I. Sh. si shitës dhe I. K. si blerës. E para është e datës 10 shtator 2001 dhe e dyta e datës 5 tetor 2001. E para nuk është vërtetuar ndërsa e dyta është vërtetuar në Gjykatën Komunale të Prishtinës me numrin Nr. 5393/2001 më 08 tetor 2001. Kjo do të thotë se I.K. ia kishte shitur pronën N. A. para se ta blinte nga I. Sh.

Pas kontratave, të gjitha palët përgjegjëse në kërkesë ishin regjistruar në fleta të ndryshme poseduese, të lëshuara nga Komuna Kadastrale e Nëntë Jugoviqve.

Asnjëri nga palët përgjegjëse në kërkesë nuk konteston se pronat në fjalë dikur (para konfliktit të armatosur) i përkisnin paraqitësit të kërkesës.

8. Pas lidhjes së marrëveshje të lartcekura është zhvilluar një hetim penal kundër I. Sh., M. I. dhe Z. B. dhe Gjykata Komunale e Prishtinës, me Aktgjykimin e datës 27.04.2009 pranoi se këta tre persona kanë kryer veprën penale të mashtrimit në bashkëkryerje dhe vazhdimësi sipas nenit 261, paragrafi 2, lidhur me nenin 23 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (2003). Gjykata komunale po ashtu ka anuluar autorizimin nr. 1247 të datës 23 prill 2001, e vërtetuar nga Gjykata Themelore e Biella Polje (ky dokument nuk është paraqitur në procedurën e tanishme civile, por nuk kontestohet se ky ka qenë një autorizim gjoja i dhënë nga D. S. Z. B. për t'i shitur pronat e Z. S. dhe në bazë të së cilës Z. B. ia kishte shitur pronat I. Sh., i cili pastaj iu kishte shitur ato prona palëve përgjegjëse në kërkesë) si dhe ka anuluar disa kontrata mbi shitjen e pronës së paluajtshme, ndër të cilat janë disa prej kontratave të cekura më lartë – si Nr. 5994/2002 Nr., 6853/2001, Nr. 1032/2003, 3294/2002, Nr. 4780/2002 të cilat janë shpallur të pavlefshme dhe pa forcë ligjore. Të tjerat - Nr. 5394/2001, Nr. 5589/2001, Nr. 3293/2002, Nr. 2543/2002 dhe Nr. 5393/2001 nuk janë shpallur shprehimisht të pavlefshme.

9. Gjatë procedurës penale është konstatuar se I.Sh. në bashkëpunim me të dy pandehurit tjerë me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për vete, ka mashtruar një numër personash (tani palët ankuese në procedurën civile të apelit dhe palët përgjegjëse në kërkesë në procedurën para AKP-së) nëpërmjet përfaqësimit të rrejshëm (gjegjësisht duke paraqitur dokumente të rrejshme se ai I. Sh. ishte pronar i pronave të kontestuara) dhe në këtë mënyrë i ka nxitur ata (të njëjtët palë ankuese dhe palë përgjegjëse në kërkesë) që të kryejnë veprime (gjegjësisht – të lidhin kontrata për transferimin e pronës, e cila nuk i përkiste shitësit – I. Sh.) në dëm të pasurisë së një personi tjetër (gjegjësisht palës përgjegjëse në ankesë, paraqitësit të kërkesës D. S.). Gjatë procedurës penale është konstatuar gjithashtu se në vitin 2004 D. S. ishte kthyer në Kosovë dhe kishte paralajmëruar njërin prej palëve përgjegjëse në kërkesë që të mos e punojë dhe shfrytëzojë pronën pasi që ai (D.) do ta kërkonte pronën, për shkak se ai asnjëherë as nuk e kishte shitur atë as nuk kishte ia dhënë autorizim diku që ta shes në emër të tij. Pak kohë pas kësaj, të gjitha palët përgjegjëse në kërkesë ishin të vetëdijshëm se paraqitësi i kërkesës ishte pronari i vërtetë dhe se ai do të kërkonte ri-posedimin (siç shpjegohet nga pala përgjegjëse në kërkesë S. D.2 gjatë procedurës penale. Ai kishte blerë një pronë nga I.Sh. në vitin 2002 dhe shpjegoi se D. S. kishte ardhur 2 vite më vonë dhe i kishte thënë se ajo ishte toka e tij dhe se ai nuk do të duhej ta kultivonte tokën apo të ndërtonte aty, dhe më pas të gjitha familjet të cilat kishin blerë prona nga I. Sh. ishin të informuara për pretendimet e S.).

Faktet të cilat i kanë ngarkuar përgjegjësi penale I. Sh. – lidhur me mashtrimin të cilin e ka kryer janë vërtetuar me *res judicata* nga gjykata penale.

Është po ashtu e pakontestueshme se në kohën e lidhjes së kontratave I. Sh. nuk ishte pronar i pronave të kontestuara. Edhe vet palët ankuese nuk e pohojnë të kundërtën.

Ndaj aktgjykimit të gjykatës komunale është paraqitur ankesë pranë gjykatës së qarkut të Prishtinës dhe është konfirmuar me një vendim, që është marrë në procedurën e apelit AP Nr. 393/2009, të datës 13 nëntor 2009.

10. Në bazë të provave të paraqitura KKPK-ja me vendimet KKPK/D/R/137/2011 (lidhur me lëndën e regjistruar në AKP me numrin KPA18191), të datës 07 dhjetor 2011 dhe KKPK/D/A/134/2011 (lidhur me lëndën e regjistruar në AKP me numrat KPA18192, KPA18193, KPA18194, 18195 dhe 18196), të datës 07 dhjetor 2011 i pranoi kërkesat e D. S. si të bazuara. Komisioni ka shtuar se e drejta e paraqitësit të kërkesës është vërtetuar pozitivisht në bazë të fletës poseduese të paraqitur dhe vendimit mbi trashëgiminë (sikurse ceket në pjesën 3) dhe aktgjykimit – vendimit të gjykatës, të datës 27 prill 2009, të marrë nga gjykata komunale në procedurën e lartcekur penale. Lidhur me kundërpaditë e palëve përgjegjëse në kërkesë Komisioni ka deklaruar se kontratat e paraqitura nga ata nuk përbëjnë mbrojtje valide kundër paraqitësit të kërkesës.

11. Vendimet iu janë dërgua palëve brenda 30 ditësh dhe pas dërgesës të gjitha palët përgjegjëse në kërkesë u ankuan pranë Gjykatës Supreme nëpërmjet një avokati të autorizuar – Z. M. N.. Ankesa shprehimisht i referohet vetëm vendimit KKPK/D/A/134/2011 (e cila ka të bëjë vetëm me procedurën pranë KKPK-së – AKP-së 18192,18193,18194, 18195 dhe 18196 dhe jo asaj AKP 18191), por gjykata konsideron se ky është një gabim teknik në përgatitjen e ankesës. Është e qartë duke marrë parasysh faktin se ankesa ndërlidh gabimisht AKP 18191 me KKPK/D/A/134/2011, kur AKP 18191 është objekt i KKPK/D/R/137/2011. Prandaj, Gjykata pranon se ankesa është kundër dy vendimeve të cekura në pjesët relevante - KKPK/D/A/134/2011 në pjesët që kanë të bëjnë me KPA18192, KPA18193, KPA18194, KPA18195 dhe KPA18196, dhe KKPK/D/R/137/2011 në pjesën që ka të bëjë me KPA18191.

12. Avokati N. pohon se me qëllim që Z. D. S. t'i realizojë të drejtat e veta ai duhet t'i drejtohet Gjykatës komunale në Prishtinë brenda 30 ditësh nga pranimi i vendimit (nuk është e qartë cilit vendim ai po i referohet. Me gjasë vendimeve të lartcekura të Komisionit). Në ankesë theksohet se vendimi i KKPK-së është marrë në shkelje të së drejtës materiale. Palët ankuese janë pronarë të pronave të kontestuara, pasi që ata janë regjistruar në fletat poseduese për këto prona. Ata të gjithë i kanë marrë këto prona në bazë të kontratave të shitblerjes së pasurive të paluajtshme, të vërtetuara dhe të legalizuara nga Gjykata Komunale në Prishtinë dhe pastaj bazuar në këto kontrata ata i kanë kompletuar procedurat administrative në Drejtoratin për Kadastër dhe Gjeodezi në Prishtinë. Ata i kanë blerë pronat nga I. Sh. sepse ato ishin të regjistruara në emrin e tij. I. Sh. ishte bërë zotërues i pronës në bazë të kontratës së shitblerjes së pasurisë së paluajtshme që kishte lidhur me Z.B. (i cili nuk është palë përgjegjëse në kërkesë në këtë procedurë, siç pohohet nga Z. N.). Të gjitha palët ankuese/palët përgjegjëse në kërkesë kanë ndërtuar shtëpi në pronat e blera dhe kanë investuar shumë në ndërtimin e tyre. Ai pranon se I. Sh. dhe dy persona tjerë – njëri prej tyre Z. B. ka kryer mashtrim, duke dëmtuar D. S. Ai po ashtu pranon se gjykata komunale ka anuluar autorizimin e falsifikuar dhe kontratat për transferimin e pronave (në fakt vetëm disa prej tyre janë përmendur shprehimisht ose me gjasë ka mospërputhje ndërmjet numrave në dokumentet e prezantuara në procedurën aktuale dhe dokumenteve siç janë të përshkruara në aktgjykim. Megjithatë, kjo është e parëndësishme pasi që faktet e mashtrimit janë vërtetuar me *res judicata*, ndërsa për kontestin aktual për pronat është jo-relevante nëse dokumentet janë përmendur shprehimisht si të anuluarat). Për më tepër, përfaqësuesi ligjor Z. N., shtjellon se pavarësisht procedurës penale, palët ankuese në mirëbesim i kanë marrë pronat e kontraktuara në posedim dhe përdorim pasi që kanë paguar çmimin e kontraktuar dhe kanë vërtetuar dhe legalizuar kontratat e shitblerjes së pasurive të paluajtshme. Në aktgjykim, lidhur me përgjegjësinë penale të të pandehurit, tani palët ankuese (personat e dëmtuar në

rastin penal) janë këshilluar, me qëllim të realizimit të kërkesës së tyre pronësore për të filluar një kontest civil). Në ndërkohë, D. S. ka kërkuar që AKP të sigurojë lirim të pronave. KPKK-ja ka marrë një vendim KKKPK/D/A/134/2011, të datës 07 dhjetor 2011 me të cilën urdhërohen palët ankuese që t'ia kthejnë pronën paraqitësit të kërkesës – tani palës përgjegjëse në ankesë. Përfaqësuesi ligjor e konsideron këtë vendim të paligjshëm pasi që AKP nuk ka të drejtë të vendos mbi çështjet pronësore sepse kjo është e drejtë e veçantë e gjykatës komunale. Palët ankuese i kanë marrë tokat në mirëbesim. Ato janë regjistruar në fletët poseduese, të cilat ishin legjitime dhe të lëshuara nga autoritetet kompetente, kontratat janë vërtetuar nga gjykata komunale në Prishtinë. Palët ankuese kanë ndërtuar shtëpi, vlera e të cilave është shumë më e lartë se vet vlera e tokës. Përfaqësuesi ligjor pohon se me ligjet e zbatueshme përcaktohet “se në rastet kur godinat kanë vlerë më të madhe se vlera e pronës atëherë duhet të arrihet një zgjidhje ndërmjet pronarëve të godinave dhe atyre që pretendojnë se janë pronarë të pronave të tilla, dhe kjo duhet të zgjidhet me procedurë gjyqësore dhe jo me procedurë administrative...”. Me gjasë, përfaqësuesi ligjor është duke iu referuar Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësore (Gazeta zyrtare RFSJ Nr. 6/80 (nenet 24-26). Përveç kësaj, më 20 prill 2012 palët ankuese kanë paraqitur kërkesë që t'u njihen të drejtat pronësore kundër D.S., I.Sh., M. I dhe Z.B. pranë gjykatës komunale në Prishtinë (një kopje e kërkesës është prezantuar me ankesën).

13. Kopja e ankesës i është dërguar paraqitësit të kërkesës, tani palës përgjegjëse në ankesë. Ai nuk është përgjigjur.

14. Para Gjykatës Supreme nuk janë paraqitur prova të reja, por kërkesa e lartcekur, e dorëzuar pranë gjykatës komunale të Prishtinës.

#### **Arsyetimi ligjor:**

15. Ankesa është e pranueshme dhe nuk ekzistojnë pengesa procedurale për të vendosur lidhur me të. Ajo është paraqitur kundër një vendimi të KKKPK-së, nga një palë në procedurë dhe është paraqitur brenda periudhës 30 ditore, pas njoftimit për vendimin, sikurse parashihet me nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079 (tani e tuje Rregullorja 2006 apo Rregullorja). Megjithatë, ankesa është e pabazuar dhe vendimi i Komisionit duhet të konfirmohet, sipas nenit 13.3 të *Rregullores 2006*. Vendimi i kundërshtuar nuk përmban gabim thelbësor apo zbatim të gabuar të së drejtës materiale apo procedural, dhe as nuk mbështetet në vërtetimin e gabueshëm apo jo të plotë të fakteve (bazat për ankesë sikurse përkufizohen me nenin 12.3, (a) dhe (b) të *Rregullores 2006*).



16. Shqyrtimi i Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme sipas nenit 12.3 të Rregullores 2006. Bazat për ankesë sikurse definoohen në vet ankesë janë: “për shkak të shkeljes së ligjit material” dhe “vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të fakteve”.

16.1. Së pari, ankesa i referohet zbatimit të gabueshëm të rregulloreve lidhur me kompetencën mbi kërkesën (që do të thotë se ankesa në mënyrë indirekte i referohet zbatimit të gabueshëm të ligjit procedural).

Pohimi se AKP-ja nuk ka pasur autoritet të vendos, nëpërmjet KKKP-së, rreth kontesteve në fjalë është i pabazuar. Sipas nenit 3.1 të Rregullores 2006, AKP ka kompetencë, nëpërmjet Sekretariatit Ekzekutiv, të pranoj dhe regjistrojë, si dhe nëpërmjet Komisionit për Kërkesat Pronësore t'i zgjidh, me të drejtë ankesë pranë Gjykatës Supreme të Kosovës, dy kategori të kërkesave që ndërlidhen me konfliktin që përfshijnë rrethanat që kanë të bëjnë drejtpërdrejtë me apo burojnë nga konflikti i armatosur që ndodhi ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999: kërkesat për pronësi dhe kërkesat që kanë të bëjnë me të drejtat e shfrytëzimit të pronës sa i përket pasurisë së paluajtshme private, përfshirë të drejtat pronësore bujqësore dhe komerciale.

Është e pakontestueshme se para konfliktit të armatosur të vitit 1998/1999 tokat e kontestuara i përkisnin paraqitësit të kërkesës D. S. Është vërtetuar se tokat qenë regjistruar që në vitin 1968 në emër të B. S., të atit të ndjerë të paraqitësit të kërkesës (Fleta Poseduese Nr. 5 e lëshuar nga Drejtorati Kadastral për Pronë të Paluajtshme në Prishtinë, e datës 19 prill 1968). Është vërtetuar se B. S. ka vdekur më 01 prill 1992 dhe është vërtetuar se me një vendim të marrë në një procedurë trashëgimie paraqitësi i kërkesës është njohur si trashëgimtari i vetëm i babait të tij të ndjerë (vendimi i gjykatës komunale të Prishtinës, që është dhënë në procedurën trashëgimore nr. 96/2000, e datës 9 nëntor 2000). Rrjedhimisht, paraqitësi i kërkesës si pranues i vetëm i të gjitha pronave të B.S. mori në trashëgimi të vet të gjitha pronat, përfshirë pronat e kontestuara.

Po ashtu, askush nuk e konteston faktin se deri deri më 19 qershor 1999 paraqitësi i kërkesës ka ushtruar posedimin, si një tipar i të drejtës së pronësisë mbi tokat në fjalë.

Gjithashtu është e pakontestueshme se paraqitësi i kërkesës humbi posedimin e tij më 19 qershor 1999 (sikurse pohohet në kërkesat lidhur me të gjitha tokat në kontest) dhe se humbja e tij ishte për shkak të konfliktit të armatosur. Si rrjedhojë, nuk ka dyshim se kontestet lidhur me tokat e Dragutin Stamenkoviçit në Nëntë Jugoviq/Devet Jugovica ishin nën juridiksionin e AKP-së, nëpërmjet KKKP-së dhe nëpërmjet të drejtës së ankesës përbrenda kompetencës së apelit të Gjykatës Supreme.

16.2 Lidhur me vërtetimin e gabueshëm dhe jo të plotë të fakteve. Sipas nenit 183.1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (më tej LPK), që është *mutatis mutandis* e zbatueshme në procedurën e ankesave pranë Gjykatës Supreme sipas nenit 12.2 të *Rregullores 2006*, ka vërtetim të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike kur gjykata vërteton një fakt material gabimisht ose nëse gjykata dështon ta vërtetojë atë fakt material. Ky pretendim nuk është i bazuar pasi që KKPK, si instancë e parë në këtë rast, nuk ka vërtetuar gabimisht ndonjë fakt relevant material dhe as nuk ka dështuar të vërtetojë ndonjë fakt relevant. KKPK e ka marrë vendimin e vet pas shqyrtimit të të gjitha fakteve relevante për rastin – kush ka qenë pronarë para konfliktit të armatosur, kush i ka poseduar pronat para konfliktit, kur është humbur posedimi, se palët përgjegjëse në kërkesë nuk i kanë blerë tokat nga paraqitësi i kërkesës, por se ata i kanë blerë ato nga dikush i cili nuk ka qenë pronar dhe faktin se palët përgjegjëse në kërkesë kanë ngritur ndërtesa të ndryshme në tokat në fjalë. Vlerësimi ligjor është një çështje tjetër dhe jo çështje e vërtetimit të drejtë apo të gabueshëm të fakteve. Si konkludim, nuk ka ndodhur vërtetimi i gabueshëm i fakteve relevante.

16.3 Lidhur me zbatimin e gabueshëm të së drejtës materiale ankesa i referohet dy pretendimeve kryesore:

16.3.1 Se palët ankuese i kanë blerë tokat nga I. Sh., se ata i kanë nënshkruar kontratat me atë si shitës, ata ia kanë paguar çmimin e pronave dhe se më pas kontratat janë regjistruar në gjykatën komunale. Ata nuk e kontestojnë faktin se I. Sh. (në bashkëpunim më njerëzit tjerë) është akuzuar në mënyrë të suksesshme para një gjykate penale dhe më vonë është dënuar për kryerje të mashtrimit duke falsifikuar dokumente dhe duke iu shitur palëve përgjegjëse në kërkesë toka të cilat nuk i takonin atij. Ata konsiderojnë se pavarësisht “problemeve” të tilla ata i kanë marrë pronat në mirëbesim, kanë paguar çmimin e kontraktuar, kanë regjistruar kontratat dhe konsiderojnë veten si pronarë.

Është parim në ligjin pronësor se askush nuk mundet të jep/transferojë diçka që ai/ajo nuk ka – *nemo dat tot non habet*. Kjo do të thotë se nëse ju blini nga dikush i cili nuk është pronar, ju nuk bëheni vet pronar. Ekziston një përjashtim të këtij parimi në rastet e transferimit të pasurive të luajtshme, pastaj personi të cilit i bëhet transferimi mund ta fitojë pronën nëse ai/ajo ka vepruar në mirëbesim në kohën e dërgesës (neni. 22 i Ligjit Nr. 03/L-154 për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore të vitit 2009, më tej Ligji i vitit 2009). Një mundësi e tillë nuk ekziston në rastet e pasurive të paluajtshme. Kjo e fundit, megjithatë mund të fitohet në bazë të parashkrimit fitues – neni 40 të Ligjit 2009, pas posedimit të pronës për 10 (nëse nën pretekstin së drejtës së titullarit dhe i regjistruar radhazi si posedues) ose 20 vite (nëse jo). Në çdo rast, uzurpimi i thjeshtë faktik nuk mjafton. Që parashkrimi faktik të transformohet në të drejtën e pronës ai duhet të vazhdojë deri në afatet kohore të cekura më

lartë; duhet të jetë agresiv, në kundërshti me interesat e pronarit të vërtetë; kjo është pjesa kundërshtuese e parashkrimit fitues; duhet të jetë i hapur, i ditur dhe aktuale me qëllim që pronari i vërtetë të jetë i vetëdijshëm se dikush është futur pa leje në pronën e tij dhe është në posedim dhe se pronari i vërtetë ka një shkak veprimi kundër poseduesit aktual – të gjitha këto janë elemente të pjesës objektive të posedimit – *corpus possessionis*. Elementi subjektiv i posedimit – qëllimi për të poseduar për vete (*animus possidendi*) duhet të supozohet si pjesë e mendimit subjektiv të poseduesit përveç nëse nuk dëshmohet ndryshe.

Në rastin e tanishëm palët përgjegjëse në kërkesë, palët ankuese në procedurën e apelit as nuk pretendojnë, as nuk kanë mundur të dëshmojnë se e kanë fituar pronën në bazë të parashkrimit fitues. Pavarësisht llojit të posedimit që mund t'i referohen hipotetikisht, ata nuk e kanë dëshmuar pjesën objektive – fillimisht ata kanë uzurpuar tokat pa njohurinë e pronarit të vërtetë, pasi që ai nuk ishte më në Kosovë dhe nuk ka mundur të di se dikush tjetër kishte marrë përsipër pronat e tija dhe së dyti, në momentin që ai ka kuptuar gjendjen ai ka reaguar dhe ka filluar haptazi të kundërshtojë duke kërkuar të drejtat e veta. Së pari, ai i tha njërit prej palëve përgjegjëse në kërkesë në fillim të vitit 2004 që të mos e përdor pronën sepse ai do të kërkonte që ta kthente, pastaj rreth kohës së njëjtë të gjitha palët përgjegjëse në kërkesë ishin të njoftuar se D. S. kërkonte tokat e veta dhe më vonë paraqiti kërkesat pranë AKP-së për ri-posedim. Rrjedhimisht, posedimi i hapur ishte ndërprerë nga pronari i vërtetë dhe koha relevante për transformimin e posedimit nuk vazhdonte më.

16.3.2. Në rastin e dytë palët ankuese pretendojnë se të gjithë ata kanë ndërtuar shtëpi në ato toka, vlera e të cilave është shumë më e lartë se vet toka, se me ligjet e zbatueshme parashihet “se në rastet kur godinat kanë vlerë më të madhe se prona atëherë duhet të arrihet në një zgjidhje ndërmjet pronarëve të godinave dhe atyre që pretendojnë se janë pronarë të tokave dhe kjo duhet të zgjidhet me procedurë gjyqësore dhe jo me procedurë administrative dhe këto shtëpi nuk mund të largohen me vendime administrative të Komisionit. Prandaj, ankesa nënkupton se vendimi i KKPK-së është i natyrës administrative dhe se ai vendim nuk mund të jetë bazë valide për dëbimin e palëve përgjegjëse në kërkesë, tani palët përgjegjëse në ankesë dhe si rrjedhojë nuk është bazë për largimin e objekteve të ndërtuara.

#### 16.3.2.1 Lidhur me ligjin e zbatueshëm:

Para, gjatë, pas dhe deri në hyrje në fuqi të Ligjit për Pronësinë dhe të drejtat tjera sendore / Ligji Nr. 03/L-154, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 25 qershor 2009 (më tutje Ligji i vitit 2009) marrëdhëniet themelore juridike pronësore janë rregulluar me Ligjin mbi marrëdhëniet themelore juridike pronësore (GZ RSFJ, Nr. 6/80, më tej Ligji 1980). Sipas nenit 3 të Ligjit të cekur “zotëruesi i pronës ka të drejtë të zotërojë një objekt, ta shfrytëzojë apo ta heq duarsh përbrenda kufijve të

përcaktuara me ligj”. Koncepti i njëjtë lidhur me përmbajtjen e të drejtës së pronës është përvetësuar në nenin 18 të Ligjit të vitit 2009).

Neni 20, paragrafi 1 i ligjit të njëjtë thotë se e drejta pronësore mund të fitohet ligj, bazuar në çështjet ligjore dhe me trashëgimi. Kjo do të thotë se cilido që pretendon se ka të drejtën e pronësisë mbi një pronë të caktuar ai/ajo duhet të dëshmojë se si e ka fituar atë pronë. Nëse një paraqitës kërkesë ka vërtetuar pozitivisht mënyrën se si ai/ajo ka fituar të drejtën e pronësisë, atëherë është detyrë e palës përgjegjëse në kërkesë ta kundërshtojë paraqitësin e kërkesës dhe të vërtetojë ose se paraqitësi i kërkesës kurrë nuk e ka fituar pronën në rend të parë ose se vet pala përgjegjëse në kërkesë e ka fituar atë kundrejt paraqitësit të kërkesës, duke përjashtuar kështu të drejtën e mëparshme të paraqitësit të kërkesës.

Neni 21 më tej jep një listë të mënyrave të mundshme të marrjes së të drejtës pronësore *ex lege* (me ligj). Njëra prej mënyrave është duke ndërtuar në tokën e dikujt tjetër.

Më tej në nenin 24, paragrafi 1 shpjegon se si një ndërtues në tokën e dikujt tjetër mund ta fitojë jo vetëm objektin që ai/ajo e ka ndërtuar por po ashtu edhe tokën në të cilin është ngritur objekti. Neni shprehimisht cek se “një person i cili mund të jetë mbajtës i të drejtës pronësore dhe i cili ndërton një shtëpi apo ndonjë objekt tjetër (objekt ndërtimi) në një tokë mbi të cilën dikush tjetër e mban të drejtën pronësore (ndërtues), ai/ajo do do ta fitojë të drejtën pronësore edhe mbi tokën në të cilën është ngritur objekti, si dhe mbi tokën që është e domosdoshme për shfrytëzim të rregullt të objektit të tillë të ndërtimit”. Megjithatë, ndërtuesi mund ta fitojë tokën në parametrat, të shpjeguara në paragrafin 1, nën kushtet e përcaktuara në paragrafin e njëjtë, d.m.th.: “nëse ai/ajo (ndërtuesi) nuk e ka ditur dhe nuk ka mundur të di se ai/ajo ka ndërtuar në tokën e dikujt tjetër, dhe pronari i tokës ka ditur për ndërtesën por nuk i ka paraqitur menjëherë kundërshtimet e tij/saj”. Paragrafi 2 i dispozitës së njëjtë shpjegon se në rast të paragrafit 1 të të njëjtit nen pronari i tokës ka të drejtë brenda afatit kohor prej tre vitesh nga dita kur ai/ajo ka mësuar për ndërtesën e përfunduar, por më së voni brenda 10 viteve nga data e ndërtesës së përfunduar, të kërkojë nga ndërtuesi kompensim për vlerën e tokës në shumën e çmimit të tregut në kohën kur është dhënë vendimi nga gjykata. Kjo do të thotë se më vonë pasi të ketë përfunduar ndërtesa, pronari mund të kërkojë vetëm kompensimin përbrenda afateve kohore, sikurse parashihet në ligj. Neni 25, paragrafi 1 trajton hipotezën kur ndërtuesi ka ditur se ai po ndërton në tokën e dikujt tjetër dhe pronari menjëherë paraqet kundërshtimet e veta. Atëherë, pronari ka të drejtë të vendos si ta zgjidh situatën me ndërtuesin, që do të përshkruhet më poshtë.

Analiza e dispozitave të lartcekura të neneve 21, 24 dhe 25 të këtij Ligji lidhur me ndërtimin e ndërtesave në tokën e dikujt tjetër shpie në konkludimin se në vitin 1980 ligjvënësi me qëllim është shmangur nga parimi Romak *superficies solo cedit* - çdo ndërtim mbi tokë i takon pronarit, me qëllim të inkurajimit të pronarëve që t’i ruajnë pasuritë e tyre ose duke i kultivuar ato ose duke i përdorur për

ndërtim (varësisht nëse ato kanë qenë toka bujqësore ose territore të urbanizuara) me kujdesin e një mbikëqyrësi të mirë dhe mos t'i lënë të pambikëqyrrur. Përndryshe, pronarët e tokave rrezikojnë t'i humbin pronat e tyre shumë lehtë në dobi të ndërtuesit nëse nuk kanë kundërshtuar menjëherë ndërtimin nën hipotezën e nenit 24, paragrafi 1 – nëse ndërtuesi nuk e ka ditur dhe nuk ka mundur të di se ai/ajo po ndërton në tokën e dikujt tjetër. Në rastet e nenit 25, paragrafi 1 – kur ndërtuesi ka ditur se ai/ajo po ndërton në tokën e dikujt tjetër, pronari i tokës nuk e ka humbur pronën menjëherë por janë paraqitur tri mundësi në dobi të tij – ose t'i jepet ndërtesa ku në këtë rast ai/ajo do të duhej ta kompensoj ndërtuesin për vlerën e objektit, ose të kërkojë rrënimin e objektit dhe të kompensohet për dëmin nga ndërtuesi, ose të kërkojë nga ndërtuesi kompensimin për tokën. Ideja e ligjvënësist që t'i inkurajojë pronarët që të kujdesen për pronat e tyre është shprehur qartazi në nenin 46 ibid, sipas të cilit e drejta pronësore pushon së ekzistuari nëse pronari braktis pronën. Dispozita shpjegon se një pronë është e braktisur kur pronari në mënyrë të padiskutueshme shpreh vullnetin e tij/saj që të mos e mbaj pronën më.

16.3.2.2 Megjithatë, Ligji i vitit 1980 nuk merr parasysh situatat emergjente si konfliktet e armatosura apo *forcat madhore* si shtrëngatat, tërmetet, etj., në përgjithësi situatat ku njerëzit detyrohen që t'i lënë pronat e tyre të pambikëqyrrura me qëllim të mbrojtjes së vlerës më të madhe të jetës së tyre dhe integritetit fizik. Kjo do të thotë se zbatimi i neneve 24 dhe 25 të Ligjit të vitit 1980 në rastet e kontesteve pronësore që kanë të bëjnë me konfliktin e armatosur të viteve 1998/1999 do të çojë në një rezultat absurd ku dikush do të privohet nga e drejta e tij/saj pronësore sepse ai/ajo është detyruar të ruaj jetën dhe integritetin fizik të tij/saj. Është e qartë se qëllimi i ligjit të vitit 1980 – *ratio legis* nuk ka qenë që t'i bëjë njerëzit t'i mbajnë pronat e tyre duke rrezikuar jetën, është përtej arsyes të mbahet/ruhet një tokë vetëm sa për ta pasur varrin tuaj aty. Prandaj, nëse dikush e ka lënë pronën e tij/saj pa mbikëqyrje me qëllim të mbrojtjes së një vlere më të madhe – jetën e vet, pronat e “braktisura” nuk mund të merren nga një person tjetër thjeshtë duke ndërtuar në ato prona. Përveç kësaj, nëse kontestet pronësore lidhur me konfliktin e armatosur do të ishin konsideruar si konteste të zakonshme pronësore atëherë UNMIK-u nuk do të kishte miratuar një legjislacion të veçantë, duke miratuar Rregulloren Nr. 2006/50 mbi zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën private të paluajtshme, përfshirë pronat bujqësore dhe komerciale, siç quhet deri më tash Rregullorja 2006. Kjo e fundit është një *lex specialis* në fushën e ligjit pronësor në Kosovë dhe mbizotëron legjislacionin e përgjithshëm pronësor. Neni 2.2 i Udhëzimit Administrativ Nr. 2007/5, që zbaton Rregulloren 2006, thekson shprehimisht se Komisioni duhet të autorizojë rivendosjen e titullarit të pronës, përveç nëse pronësia është fituar nga një person fizik nëpërmjet kontratës së vlefshme dhe me dashje për vlerën para datës së hyrjes në fuqi të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50. Në kontestet në fjalë, është vërtetuar se pronari kurrë nuk i ka shitur pronat e veta me kontrata valide dhe për ndonjë vlerë para

hyrjes në fuqi të Rregullores. Rregullorja nuk parasheh që pronarit t'i refuzohet rikthimi sepse dikush tjetër ka ndërtuar në pronën e tij/saj.

16.3.2.3 Në fund palët përgjegjëse në kërkesë, nëse dëshirojnë t'i shmangen dëbimit dhe të qëndrojnë në prona, duhet ta blejnë tokën nga pronari i vërtetë (është rregull zakonore se ai që paguan keq paguan dy herë). Për dëmet të cilat kanë pësuar, ata duhet të kërkojnë ndërmarrje e veprime përmirësuese civile nga ai i cili ka shkaktuar këto dëme, nga personi i cili iu ka shitur atyre pronat duke u shtirur si pronar (shih kapitullin II, nenin II të Ligjit për marrëdhëniet detyrimore të vitit 1978 apo dispozitat relevante të Ligjit Nr. 04/L-077 Ligji mbi marrëdhëniet e detyrimeve, miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 10 maj 2012 i cili do ta zëvendësojë Ligjin e vitit 1978 6 muaj pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, kur të hyjë në fuqi).

Përfundimisht, pavarësisht se çfarë lloji detyrimesh mund të jenë shfaqur ndërmjet palëve përgjegjëse në kërkesë dhe pronarit në njërën anë dhe ndërmjet palëve përgjegjëse në kërkesë dhe shitësit të pronave, ato detyrime janë jashtë juridiksionit të Kolegjit të Apelit, i cili është i autorizuar të vendos vetëm rreth kërkesës pronësore.

17. Lidhur me pohimin se “një vendim administrativ” nuk mund të jetë bazë për largimin e objekteve të ndërtuara në tokën e dikujt tjetër:

Së pari, nuk është e saktë se nuk mund të urdhërohet demolimi i ndërtesave me një vendim administrativ, përkundrazi është zakonisht brenda të drejtave të posaçme të një administrate të veçantë që të urdhërojë demolimin e objekteve (pavarësisht së në pronën e kujt ndodhen), të cilat konsiderohen të ndërtuara ilegalisht, të rrezikshme për jetën e njerëzve, për shembull – sipas nenit 34.1 të Ligjit Nr. 04/L-110 të viti 2012) inspektorët e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor janë të autorizuar të urdhërojnë demolimin e ndërtesave, nëse ka parregullsi të pakorrigjueshme e cila rrezikon stabilitetin e ndërtesës dhe *per argumentum a fortiori* administrata e specializuar do të ishte e autorizuar të urdhërojë demolimin e ndërtesave për të cilat nuk është lëshuar fare leja e ndërtimit. Kjo nuk ndërlidhet drejtpërdrejtë me rastin e tanishëm, por demonstroi gabimin në argumentim se administratat nuk mund të urdhërojnë demolimin e ndërtesave.

18. Lidhur me natyrën juridike të vendimit të marrë nga KKPK:

Sipas nenit 11.1 të Rregullores 2006, përveç nëse parashihet ndryshe në vet rregulloren dhe Udhëzimin Administrativ që zbaton Rregulloren, dispozitat e Ligjit mbi Procedurat Administrative do të jenë të zbatueshme *mutatis mutandis*. Zbatimi subsidiar i Ligjit mbi Procedurën Administrative nuk do të thotë se vendimi i KKPK-së është një vendim i natyrës administrative. Sikurse është shpjeguar tashmë, AKP është krijuar të vendos rreth kërkesave pronësore që kanë të bëjnë me

konfliktin e armatosur të periudhës 1998/1999. Në rastet kur kërkesa është e pakontestuar (gjë që nuk është në rastin e kërkesave të tanishme) procedura zhvillohet vetëm ndërmjet KKPK-së dhe paraqitësit të kërkesës, KKPK-ja në mënyrë të njëanshme, në bazë të të drejtave të veta të posaçme, të dhëna me Rregulloren dhe në bazë vetëm të kërkesës vendos nëse do ta pranojë ose jo – neni 11.2, propozimi i parë *ibid*. Në të kundërtën, kurdo që një person i tretë informon Sekretariatit Ekzekutiv rreth qëllimit të tij/saj që të merr pjesë në procedurën administrative, sepse ai/ajo momentalisht është duke i ushtruar të drejtat apo pretendon t'i ketë të drejtat mbi pronën që është objekt i kërkesës, atëherë KKPK duhet ta merr vendimin e vet bazuar jo vetëm në kërkesë por edhe në përgjigjet dhe provat, të paraqitura nga paraqitësi i kërkesës dhe nga palët përgjegjëse në kërkesë – neni 11.2, lidhur me nenin 11.6 dhe nenin 10.2 *ibid*. Neni 11.6 në veçanti parasheh mundësinë që Komisioni të kërkojë shkresa të mëtejme nga palët, të mbajë seanca dëgjimore të të gjitha palëve të përfshira, përfshirë dëshmitarët dhe ekspertët. Kjo do të thotë, se në rastet e kërkesave të kontestuara procedura pranë KKPK-së bëhet konfliktuoze, d.m.th. nuk është më thjeshtë administrative. Konkludimi përfundimtar do të ishte se KKPK-ja në rastet e kërkesave të kontestuara nuk vepron më si një administratë, por si organ kuazi-gjyqësor, me funksione gjyqësore.

Dhe në fund, pavarësisht natyrës së saktë ligjore të procedurës pranë KKPK-së dhe vendimeve të lëshuara nga ajo, rregullorja në nenin 15 shprehimisht thekson se mjetet juridike për ekzekutimin e vendimit të Komisionit “mund të përfshijnë, por nuk kufizohen në, dëbimin, vendosjen e pronës nën administrim, marrëveshje qiraje, konfiskim dhe demolim të strukturave të paligjshme dhe ankandin”. Rrjedhimisht, referimi se demolimi i ndërtesave nuk mund të lejohet është i pabazë. Përveç kësaj, deri më tani Komisioni nuk ka urdhëruar demolimin e ndërtesave, por vetëm dëbimin e personave që kanë uzurpuar pronën, sikurse mund të shihet nga vendimet individuale, relevante për secilën prej 6 kërkesave që janë objekt i kësaj lënde.

19. Në përfundim, vendimi i KKPK-së është marrë ligjërisht pa baza për ta kundërshtuar atë sipas nenit 12.3 të Rregullores 2006, të referuan në ankesë dhe duhet të konfirmohet në përputhje me nenin 13.3 (c) *ibid*.

### **Shpenzimet e procedurës:**

20. Në bazë të Shtojcës III, nenit 8.4 të Urdhërësës Administrative (UA) 2007/5 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, palët lirohen nga shpenzimet e procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit. Megjithatë, një përjashtim i tillë nuk është i paraparë për procedurat para Kolegjit të Apelit. Si pasojë, regjimi normal i pagesës së taksës gjyqësore të paraparë më Ligjin mbi Taksat

Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK-së, 3 tetor 1987) dhe me UA Nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi unifikimin e taksave gjyqësore për procedurat para Kolegjit të Apelit Kështu që, tarifat e mëposhtme të gjykatës zbatohen për procedurat aktuale të apelit:

- taksa nga tarifa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (neni 10.11 i UA 2008/2): € 30
- taksa nga tarifa gjyqësore për nxjerrjen e aktgjykimit (10.21 dhe 10.1 i UA 2008/2) duke pasur parasysh se vlera e pronës në fjalë në mënyrë të arsyeshme mund të përlllogaritet të jetë mbi € 90000: € 500 (€ 50 + 0.5% of 90.000, por jo më shumë se € 500).

Këto tarifa gjyqësore duhet të merren përsipër nga ankuesit (secili nga këta duhet të paguaj nga 53 euro) dhe të paguhet mbrenda 15 ditësh nga njoftimi i këtij vendimi. Në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, atëherë bëhet zbatimi i detyrueshëm i pagesës.

**Këshillë juridike:**

Në përputhje me Nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

**Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, EULEX**

**Elka Filcheva-Ermenkova, Gjyqtare e EULEX-it**

**Sylejman Nuredini, Gjyqtar**

**Urs Nufer, Referent i EULEX-it**